

VENDIM
Nr. 5, datë 6.1.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GRABOVA HYDROPOWER” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2584/1 prot., datë 30.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Grabova Hydropower’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Grabova Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2595 prot., datë 20.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova”, me kapacitet të instaluar 14.9 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, qarku Elbasan.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Grabova Hydropower” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim-operim-transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit ‘Grabovë I’”, nr. 2623 rep., nr. 1238/2 kol., datë 20.11.2017, kontratën shtesë të koncesionit nr. 1020 rep., nr. 304 kol., datë 8.4.2022, si dhe kontratën shtesë të koncesionit nr. 2524 rep., nr. 945 kol., datë 15.5.2024.

- Ka nënshkruar me “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të HEC ‘Grabova 1’”, nr. 4091/4 prot., datë 4.11.2024.;

- Ka depozituar në ERE, vendimin nr. 9, datë 24.3.2022, “Për miratimin e lejes ‘Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik shoqërisë ‘Grabova Hydropower’ sh.p.k.’” të Këshillit të Basenit Ujor (KBU) Seman, si dhe lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor nr. 230 prot., datë 31.3.2022, e lëshuar nga KBU Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është sipas kontratës së koncesionit.

- Ka depozituar vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 20.4.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i HEC ‘Grabova-1’”, me fuqi të instaluar 14 900 kw. Kjo VNM është e vlefshme deri më datë 20.4.2025. Duke qenë se nga shoqëria nuk është dhënë ndonjë informacion në lidhje me fillimin e zbatimit të projektit, vlerësohet t’i kërkohej të depozitojë këtë informacion në ERE.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë;

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

-germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin e saj;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

-germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin që vërteton aftësinë e saj financiare për realizimin e projektit, në përputhje me vlerën e investimit të përcaktuar në kontratën me MIE-n, si dhe parashikimin e planit të biznesit në lidhje me mënyrën e financimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Grabova Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Grabova 1”, me kapacitet të instaluar 14.9 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Grabova Hydropower” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti